

Margaret Drakenberg  
Juhani Hytonen  
Cveta Razdevsek Pucko  
Geri Smyth

## **STUDIMET PASDIPLOMIKE PËR MËSUESIT KLASORË -STUDIM KRAHASIMTAR**

### **1. HYRJE**

Dëshirojmë që në fillim t'i citojmë disa informata për studimet e shkallës së tretë:

Studimi pas-diplomik për mësuesit, madje edhe për ata të dy cikleve të fillores, **nuk është më “titull që e meriton një pakicë”** (Strathclyde, Programi në Jordanhill ). **Programet e tilla janë “përpiluar për t'i përgatitur mësuesit të punojnë nëpër shkolla fillore dhe të mesme në përputhje me kërkesat e shekullit të ri të arsimit”** (Programi për magjistraturë të pedagogjisë në La Trobe).

Besojmë se këto ide mund ta orientojnë diskutimin tonë për studimet pas-diplomike për mësuesit, në kontekst të zhvillimit të tyre profesional.

Ky punim bazohet në studimin krahasimtar të tetë programeve të shkallës së tretë (nga pesë vende të ndryshme), të përpiluara edhe për mësuesit klasorë, apo pikërisht për ta:

Magjistratura e mësimdhënjes (MTeach) Magjistratura në pedagogji	La Trobe University, Studimet pas-diplomike në pedagogji, Bundoora Victoria, Australia
Magjistratura në pedagogji Magjistratura në shkencë, Magjistratura në pedagogji	The Open University, Milton Keynes Britania e Madhe Jordanhill Scheme, University of Strath- Glasgow, Skotlandë, Britani
Ed.Lic. dhe Ed.D Edukimi klasor	Universiteti në Helsinki Fakulteti i edukimit, Finlandë
Certifikata e magjistraturës në Maryland (MMCP)	Universiteti në Maryland College Park, Kolegji i Edukimit, ShBA
MA në lidhshpirtin e edukimit dhe studimet politike (EDPA MA)	Universiteti në Maryland, College Park, Kolegji i Edukimit, ShBA
Programet e shkallës së tretë në Suedi (përgjithsisht)	

### **2.PREZANTIM I SHKURTË I PROGRAMEVE**

#### **2.1. Studimet e pas-diplomës për mësuesit klasorë në Finlandë**

Programet e edukimit të mësimdhënësve në Finlandë u ndryshuan dy herë në vitet shtatëdhjetë. Poashtu, në 1979, edukimi i mësuesve të fillores (klasorë) u shndërrua në një program universitar që zgjat katër vjet e gjysëm. Ky program përmban më shumë studime teorike- kryesisht në fushën e pedagogjisë- krahasuar me studimet e mëparshme. Në fund, studenti mësues duhet të shkruajë një punim në fushën e edukimit dhe ta marrë magjistraturën M.Ed. Në programin e mësimdhënësve të fillores (M.Ed), lënda kryesore është edukimi, me theks në didaktikën, apo në hulumtimin e mësimdhënies. Kurikuli përmban një kalim nga praktika në teori dhe sërish në praktikë, duke e shfrytëzuar njohurinë e metodave të ndryshme hulumtuese. Programi i mësuesit të fillores (M.Ed.) korrespondon me 160 njësi krediti (apo javë studimi). Secila javë përfshin përafërsisht 40 orë pune të studentit. Vlerësohet se për ta fituar titullin M.Ed. nevojiten katër deri pesë vite.

Nga këto fakte del se studimet pas-diplomike për mësuesit klasorë në Finlandë korrespondojnë me studimet për licensë në edukim (Ed.Lic.) apo për doktorat (Ed.D.). Programi për licensë korrespondon me 80 javë studimi, ndërkaq programi i doktoratit me 160 javë. Edhe pse ka mundësi që doktorantura të vazhdohet menjëherë pas magjistraturës, rekomandohet që studentët njëherë ta përfundojnë studimin Ed.Lic. Rëndom, nëse një student i shkallës së tretë i regjistron Ed.Lic para Ed.D, më pastaj e zgjeron tezën e Ed.Lic. në tezë doktoranture.

Struktura e studimeve të shkallës së tretë për mësuesit klasorë jepet sa vijon. (Edhe pse hollësitrat lidhen me programin pas-diplomik të Universitetit të Helsinkit, edhe programet e tjera në Finlandë janë shumë të ngjashme).

#### **Licensa në Edukim (80 javë studimi : j.s.)**

- |   |         |
|---|---------|
| 1. Metodologjia e hulumtimit I  | 5 j.s.  |
| 2. Teoria e edukimit ( përmbajtja zgjidhet sipas temës së tezës)            | 5 j.s.  |
| 3. Seminar hulumtimi (tre semestra pjesëmarrje aktive janë të domosdoshme)  | 5 j.s.  |
| 4. Metodologjia e Hulumtimit II ( përmbajtja zgjidhet sipas temës së tezës) | 5 j.s.  |
| 5. Teza për Ed.Lic  | 40 j.s. |
| 6. Studime të larta në një nga fushat e M.Ed.                               | 20 j.s. |

#### **Doktorati në edukim (80 j.s.)**

- |                 |         |
|-----------------|---------|
| 7. Dizertacioni | 80 j.s. |
|-----------------|---------|

Programi i shkallës së tretë për mësuesit është mjaft “akademik”. Edhe pse rekomandohet që të zgjidhet tema e tezës nga puna e përditshme e shkollës apo e mësuesit, megjithatë, nuk ka mundësi që ndonjë nga modulat të kompenzohet me përvojë meritore në mësimdhënie praktike. Sidoqoftë, struktura e studimeve pas-diplomike në praktikë është mjaft fleksibile. Për shumicën e moduleve ka një listë të caktuar të literaturës, dhe nëse nevojitet të shkruhet ndonjë esej apo të zgjidhet ndonjë problem, literaturën plotësuese e sigurojnë profesorët. Kjo është mënyra standarde për plotësimin e një moduli. Ekziston edhe alternativa e pjesëmarrjes (aktive) në një seminar apo kurs për studentët e shkallës së tretë, në vend të esejit. Seminaret dhe

kurset për studentët e shkallës së tretë ofrohen edhe në nivel lokal edhe në atë kombëtar.

## **2.2 Studimet pas-diplomike në Skotlandë**

### **Konteksti**

Në sistemin skotlandez të edukimit të gjithë mësimit duhet të kenë një diplomë universitare, dhe përpos saj edhe kualifikim në mësimit. Kjo do të thotë diplomë në fakultetin e edukimit apo në ndonjë fakultet tjetër, pas të cilit nevojitet edhe një vit studimi në shkallën e tretë të mësimit.

Shkollimi skotlandez ka një histori të gjatë të kurseve për mësimit në shërbim, të cilat i ofronin institucionet e edukimit për mësues dhe autoritet lokale për arsim. Vite me rradhë mësuesit kanë mundur të fitojnë kualifikime plotësuese dhe të specializuara, si:

- Mësimit e fëmijëve
- Diploma për arsim
- Diploma për mësimitien e anglishtes si gjuhë e dytë
- Diploma për udhëheqje

Kualifikimet e këtilla merren me një kombinim të provimeve me shkrim dhe orëve praktike të vëzhguara. Këto kurse rëndom nuk kanë qenë parakusht për promovim në punë por shpesh konsiderohen si të dëshirueshme. Kurset kanë reputacion të lartë në fushat përkatëse për kombinimin e suksesshëm të Teorisë me Praktikën.

Gjatë pesë viteve të fundit, janë shtuar mundësitë për studime të shkallës së tretë të mësimit, jo vetëm në nivel magjistrature, por edhe për doktoranturë në fushën e edukimit.

Shumica e studimeve pas-diplomike në Skotlandë ofrohen në formë modulare, ashtuqë studentët mund të zgjedhin një rrugë fleksibile deri tek titulli, sipas nevojave dhe interesimeve specifike. Studimet pas-diplomike në edukim ofrohen si leksione apo hulumtime, apo si kombinim i këtyre të dyjave.

Studentët kanë mundësi që të bëjnë akreditimin e përvojës apo mësimeve të mëparshme të cilat mund të llogariten në programin e obliguar për studimet e shkallës së tretë. Kjo shemë ( SCOTCATS- Shema e akumulimit dhe transferimit të krediteve në Skotlandë) ka qenë faktori kryesor për rritjen e numrit të kuadrit profesional që i ka përsosur njohuritë e veta, jo vetëm në fushën e arsimit.

### **Universiteti i Strathclyde, Jordanhill Campus, Fakulteti i Mësimit**

**Programi Jordanhill** është më i madhi përkaq numri i studentëve në Skotlandë, dhe një ndër më të mëdhenjtë në Britaninë e Madhe, me më se 3000 studentë që për momentin i vijojnë studimet e magjistraturës.

Programi është përpiluar “... për kuadrin profesional që vazhdon të përsoset profesionalisht përtej kualifikimit të vet fillestar. Nuk është thjesht program për disa të zgjedhur”.

Magjistratura shkencore në studimet e larta profesionale jepet pasi që të merren 180 pikë në nivelin e Magjistraturës skotlandeze (MS). Këto poena mund

të merren sipas sistemit SCOTCATS nëpërmjet një kombinimi të njohurive dhe përvojës paraprake, që është fituar në universitet me modulat e programit të fakultetit përkatës, por, këtu duhet patjetër të përfshihen 60 MS pikë nga modula e Metodave të Hulumtimit dhe nga ndonjë projekt i rëndësishëm hulumtues, që në fund të punohet Teza.

Poashtu në Jordanhill ka mundësi të regjistrohen studimet e pas-diplomës, qoftë për magjistraturë apo doktoranturë në fushën e filozofisë, dhe njëkohësisht të merren lëndë në fushën e edukimit për të përfunduar me titullin e magjistratit apo doktorit në fushën e edukimit. Shumica e studentëve në shkallën e tretë i paguajnë vetë studimet, dhe çdo vit ofrohen një numër i vogël bursash.

### **2.3. Britania e Madhe- The Open University**

Universiteti The Open University, edhe pse gjendet në Milton Keynes të Anglisë, është i njohur në gjithë Evropën si qendër e cila ofron studime nga distanca.

Në Open University ofrohen kurse të shkurta dhe materiale studimore, poashtu dhe kurse universitare të hapura për të gjithë, pavarësisht nga përgatitja paraprake akademike.

Fakulteti i edukimit në Open University është i njohur për standardet e larta të publikimeve si dhe për kurset profesionale për mësuesit dhe të tjerët që përfshihen në sektorin e edukimit.

Open University ofron një numër certifikatash të shkallës së tretë dhe diploma për profesionistët në këto fusha të edukimit:

- Menaxhmenti në edukim
- Nevojat speciale në edukim
- Edukimi gjuhësor

Këto diploma mund të llogariten si njëra nga tri modulat e nevojshme për titullin Magjistër i Arteve në Edukim (MA(Ed)). Programi i studimeve e për MA(Ed) është “edhe sfidues intelektualisht edhe i rëndësishëm profesionalisht”.

Për momentin kërkohet shtetësia në Unionin Evropian apo në ndonjë vend tjetër të Evropës me të cilin Open University ka marreveshje gjatë periudhës së studimeve, në mënyrë që të fitohet titulli nga ky universitet.

Studentët që dëshirojnë të fitojnë MA(Ed) mund të zgjedhin tre modula nga kjo listë:

- Zhvillimi i fëmijës
- Gjuha dhe shkrim-leximi
- Kurikuli gjithëpërfshirës
- Mentorimi
- Edukimi në fillore: vlerësimi dhe planifikimi i të nxënit
- Menaxhimi në edukim
- dhe të tjera

Vlerësimi i modulave bëhet edhe nëpërmjet esejeve edhe nëpër projekteve të vogla të hulumtimit, ndërkaq në disa raste ka edhe provim me shkrim. Disa modula e kanë të obliguar pjesëmarrjen në një shkollë me konvikt.

Shumica e studentëve paguajnë vetë për studime, por ka raste kur punësuesit ofrojnë përkrahje financiare.

Këtij viti (1997/ 98) Open University prezantoi programin e Doktoranturës në Edukim (Ed.D) të cilin e ndjekin rreth pesëdhjetë studentë. Për momentin është e obligueshme që kandidatët e interesuar ta përcjellin këtë program të Open University, ta kenë marrë titullin MA(Ed) nga ky universitet. Studentët duhet të përcaktohen për disiplinën që duan ta përsosin në përputhje me modulat e studiuara në nivelin e magjistraturës. Përpara se të pranohen në programin Ed.D, studentët poashtu duhet të kenë kaluar një modulë të specializuar për Hulumtim Aktiv në Edukim, dhe duhet të kenë dorëzuar një projekt të hollësishëm të hulumtimit.

Doktorantuara fitohet pas mbrojtjes së suksesshme të disertacionit prej 30-40 000 fjalësh.

## **2.4. La Trobe University – Studimet e larta në edukim**

### **Magjistratura në edukim me kurse**

Magjistratura me kurse është e përpiluar për studentët që kanë interesim profesional në edukim dhe që dëshirojnë t'i përsosin njohuritë teorike. Magjistratura me kurse përmban 8 njësi semestrare (180 pikë krediti).

### **Magjistratura e mësimdhënies (Mteach)**

Ky program është përpiluar për të dhënë diploma në mësimdhënie dhe për të ofruar përvojë dhe njohuri në mësimdhënie.

Theksohet se ky program “është i përpiluar për të përgatitur mësues që punojnë në shkolla fillore dhe të mesme, në përputhje me shekullin e ri të arsimit. Qendra e këtij kursi do të jetë mësuesi si hulumtues i cili reagon drejtpërsëdrejti në nevojat e klasës.”

### **Kursi ofron**

- një hyrje intenzive për çështje të ndërlydhura me shkollimin bashkëkohor;
- hulumtim dhe debat teorik lidhur me problematikat bashkëkohore;
- zhvillimin e një teorie të përgjithshme të edukimit që e influencon debatin e shkollës dhe diskutimin për karakterin e shkollës;
- mbikqyrjen e një projekti individual apo grupor që hulumton mënyrat e avancimit të përvojës shkollore.

### **Struktura e kursit**

Kursi ofron tetë njësi semestrare:

1/ Praktikë profesionale (2 njësi semestrare)

Vendosja në shkollë gjatë një semestri shkollor. Janë të detyrueshme obligimet e rregullta të personelit, dhe gjatë këtij semestri mund të orientohet theksi kah projekti i hulumtimit shkollor.

Mësuesit që kanë përvojë pesëvjeçare të mësimdhënies mund të kërkojnë anulohet kjo periudhë.

2/ Principet pedagogjike dhe praktika (një njësi semestrare)

Studentët mund të shqyrtojnë edhe mënyra konvencionale edhe risi në mësimdhënie.

Përqëndrimi është në mësimdhënien klasore, dhe në debatimin e përvojave të mëparshme të mësimdhënies që ka pasur studenti.

3/ Përpilimi dhe zbatimi i kurikulit (një njësi semestrare)

Studentët duhet të fitojnë njohuri për pikëpamjet moderne rreth kurikulit si dhe për aspektet historike dhe kritike të përpilimit të kurikulit.

4/ Projekti i hulumtimit- puna në teren (teza sekundare ) (tri njësi semestrare)

Studimi në teren nënkupton 50 ditë në një shkollë apo në ndonjë institucion tjetër arsimor. Studenti zgjedh një temë të përshtatshme hulumtimi, bën studime, hulumton të dhëna, i interpreton ato, dhe raporton për hulumtimin e vet në një projekt hulumtues prej 10 000 deri 12 000 fjalësh. Është i dëshirueshëm kontributi për përvojën e shkollës përkatëse.

5/ Një lëndë zgjedhore nga lista M.Ed ( 1 njësi semestrare)

## **2.5 Universiteti në Maryland në College Park, Fakulteti i Edukimit**

“Magjistratura dhe Doktorantura kanë për qëllim t’ju përgatisin për karrierë. Theksi është i përqëndruar në dizajnimin e programit sipas interesimeve dhe nevojave individuale “ ( Broshura e informacionit, 1997-98).

**2.51 Programi i certifikatës të magjistraturës në Maryland (MMCP)** është një program alternativ për mësimdhënësit, i përpiluar për personat e arsimuar dhe të shkathët, të cilët kanë diploma në ndonjë fushë akademike. Programi është sidomos i përshtatshëm për kandidatët me studime të ndonjë fushe të ndryshme nga ajo e edukimit, që kanë vendosur të orientohen në mësimdhënie. Me këtë program studentët fitojnë titullin e magjistratit dhe i plotësojnë kërkesat për Certifikatën Maryland për mësim në shkollat filllore apo të mesme.

Konkurenca për këtë program është tejet e lartë (nga 200 konkures pranohen rreth 25 studentë në vit).

Ky është një program i plotë i një viti kalendarik: dy sesione të shkollës verore gjashtëjavëshe dhe dy semestra të plotë të vitit akademik (rreth 45 orë semestrare /kredite). Aplikantët duhet të marrin kurse plotësuese që t’i plotësojnë përmbajtjet e disa aspekteve akademike.

Kurikuli bazohet në teori, hulumtim, dhe njohuri nga pesë fusha studimore-

- (1) hulumtime naturaliste në klasë të mësimdhënësve efikas dhe me përvojë;
- (2) hulumtime në psikologjinë kognitive lidhur me natyrën e të nxënies dhe me natyrën e mësimdhënies;
- (3) studime të teorisë të bazuar në programet e edukimit;
- (4) hulumtim i shkollave efektive dhe i udhëheqësisë në edukim; dhe
- (5) hulumtim i të nxënies të mësimdhënies. Programi përfshin përvoja të drejtpërdrejta të përpiluara me kujdes.

### **Struktura e programit:**

#### Sesioni i parë (Vera I):

Modelet dhe proceset e mësimdhënies (3 kredite)

Baza kognitive për mësimdhënie (3 kredite)  
Mësimdhënia si profesion (3 kredite)

#### Semestri vjeshtor

Hulumtim i mësimdhënies efikase (3 kredite)  
Mësimi i leximit dhe shkrimit nëpër kurikul (3 kredite)  
Hulumtimi dhe statistika në edukim (3 kredite)  
Proseminar (1 kredit)  
Metodat specifike lëndore (3-6 kredite)  
për shkolla fillore ose të mesme

#### Semestri pranveror

Hulumtimi i mësimdhënies (3 kredite)  
Mësimdhënia filletare (8 kredite)  
Proseminar (1 kredit)

#### Sesioni i dytë (Vera II):

Proseminar/ studim i pavarur (3 kredite)  
Veçantitë e kurikulit ( 3 kredite)

Një nga kërkesat e këtij programi është të përpilohet një **dosje** që përmban shembuj të ndryshëm nga mësimdhënia e studentit (planin e mësimin, fragmente, mësim të incizuara, fotografi, punime të nxënësve, etj), punime nga kurset, si dhe projekte nga hulumtimet.

## **2.52 Universiteti i Maryland**

### **Dega e politikës, planifikimit, dhe administrimit të edukimit**

#### **Magjistratura në lidhje të edukimit dhe në studime politike (EDPA MA)**

“Ky program ofron mundësi të hulumtimit të qëllimeve të edukimit dhe të rolit që mund ta luajë edukimi në një shoqëri demokratike dhe pluraliste. Ai ofron mundësi për hulumtimin e burimit të çështjeve, definimit të problemeve dhe shpalljes të “zgjdhjeve”

“  
Është e qartë se programi i këtillë nuk është i përpiluar për mësuesit klasorë /të shkollave fillore, “ programi është përpiluar për individët të cilët kanë interesime të ndryshme arsimore dhe aspirata profesionale. Ai u shërben individëve të cilët dëshirojnë ta ushtrojnë lidhshpën ashtu si dhe individëve të cilët dëshirojnë ta forcojnë aftësinë e vet për t’i përballur përgjegjësitë bashkëkohore profesionale”.

(Përshkrim i një EDPA MA, prill 1966, dhe propozim programi, korrik 1996)

Po në këto informacione mund të gjendet përshkrimi i përmbajtjes dhe komponenteve të programit, ku fjalët *lidhshpë* dhe *politikë* kanë një kuptim të gjërë: *lidhshpë* është “ një ndikim i përgjegjshëm shoqëror”, që ka të bëjë jo vetëm “me rolet specifike në organizata, lidhshpën mund ta ushtrojnë individët e ndryshëm në mënyra të ndryshme”; dhe *politika*” si një drejtim i qëllimshëm veprimi, një ndër zgjidhjet e mundshme të reagimeve alternative ndaj problemeve shoqërore...”.

Një orientim i këtillë e bën programin e lidhshpës në edukim dhe politikës arsimore që t’u qaset aspekteve kontekstuale dhe kritike të lidhshpës dhe politikës në edukim me anë

të kurseve formale, studimeve në teren, dhe punimit seminarik në magjistraturë ( nuk vlen si verzion i tezës) apo nëpërmjet tezës së magjistraturës dhe një provimi të gjerë të magjistraturës.

**Komponentet e programit:**

1. Perspektivat disiplinare dhe multi-disiplinare (12-15 kredite)
2. Metodatat e hulumtimit dhe të analizës (9 kredite)
3. Seminaret të fokusuara (3-9 kredite)
4. Studime paralele (0-6 kredite)
5. a/ opcioni pa tezë: studime në teren (3 kredite), seminari i shkruar (3 kredite)  
b/ opcioni i tezës: Teza e MA (6 kredite)

Këto komponenta të ndërlidhura programore ofrojnë parametra të përgjithshëm brenda të cilave studentët dhe mentorët e konstruktivisht programin e studimeve sipas prirjeve individuale.

*Sidomos Seminarit e fokusuar* ofrojnë shumë mundësi për analiza të thella të problemeve të ndryshme në fushën e edukimit, ndërsa *Studimet paralele* inkurajojnë hulumtime të temave nëpër programet e departamenteve të tjera, të cilat pastaj mund të përfshihen për ta plotësuar apo zgjeruar programin individual të studimeve.

Në tezën e punimit seminarik që kërkohet për titullin e magjistraturës, studentët hulumtojnë tema përtej atyre që i kanë përpunuar nëpër kurse, apo shqyrtojnë problemet e hasura më herët gjatë punës, kësaj here në mënyrë më të hollësishme. Kandidatët që e zgjedhin opcionin e tezës, e mbrojnë tezën e kompletuar në një provim me gojë.

**2.6 Studimet e shkallës së tretë për mësuesit klasorë në Suedi**

Studimi pas-diplomik në Suedi është prej 4 deri 4 vjet e gjysëm( 160 pikë). Gjatë dy viteve të para të studimit, studentët e shkallës së tretë dikur fokusoheshin në kurse të ndryshme në mënyrë që t'i thellonin njohuritë e tyre sidomos në aspektet teorike dhe metodologjike. Kohëve të fundit, një numër kursesh dhe pikësh janë zvogluar. Koha e mbetur u kushtohet studimeve empirike dhe shkrimit të tezës së doktoranturës.

Zgjidhja e kurseve është fakultative, por rëndom studentët e diskutojnë me mentorin rëndësinë e kurseve për interesimin e studentit dhe punimin e tezës së caktuar. Kurset e shkallës së tretë në universitet janë të disiplinave dhe interesimeve të ndryshme, që konsiderohet si përparsi, si nga ana e studentëve, edhe nga perspektiva e profesorëve.

**Financat**

Studimet pas-diplomike janë të kushtueshme dhe në Suedi ka shumë më tepër studentë të interesuar për këtë lloj studimesh se sa që kanë institucionet mundësi t'i përkrahin ekonomikisht këta studentë. Pozita e asistentit në institucion, nënkupton të ardhura të cilat mundësojnë një jetë të arsyeshme, dhe përpos kësaj duhet ofruar mësimdhënie si dhe përkrahje institucionale të llojeve të ndryshme, por shumica e kohës i kushtohet studimit pas-diplomik. Llogaritet se pozita e asistentit mund t'i shtyjë studimet për gjysëm viti, por jo më shumë. Në praktikë nuk ndodh gjithnjë kështu.

Meqë vetëm disa studentë pas-diplomikë e kanë pasur këtë mundësi- shumica e institucioneve kanë pranuar më tepër studentë se sa që mund të përkrahin ekonomikisht-rrjedhimisht shumica e studentëve janë të detyruar t'i ruajnë vendet e punës dhe t'i kushtohen studimit vetëm gjatë kohës së lirë. Kjo do të thotë se në shumicën e rasteve koha e përfundimit të tezës së doktoranturës e tejkalon llogarinë fillestare prej 4 deri në

katër vjet e gjysëm. Do të thosha se kjo situatë ka qënë tipike për shumicën e disiplinave në shkencat shoqërore, përderisa për studentët e shkallës së tretë në disiplinat e tjera, si për shembull në shkencat natyrore, gjendja është krejtësisht tjetër. Kohëve të fundit situata po ndryshon edhe për studentët pas-diplomikë në shkencat shoqërore, meqë departamentet, gjithnjë e më shumë, nuk po pranojnë më shumë studentë se sa që mund të mbështesin.

### **3. CILA ËSHTË STRUKTURA E PROGRAMEVE TË SHKALLËS SË TRETË? ÇFARË NJOHURISH TË PËRGJITHSHME PËRFSHIJNË KËTO PROGRAME?**

Pasiqë i shqyrtuam programet e mësipërme, ka mundësi të nxiren disa njësi të përbashkëta, të cilat gjenden në të gjitha programet:

#### **1. Studimet kurikulare**

Njohuri nga pikëpamjet bashkëkohore për kurikulin dhe strategjitë e planifikimit të ndryshimeve të kurikut. Ndikimi i ndryshimeve shoqërore në politikën e shkollës dhe në përpilimin e kurikut.

#### **2. Metodatat e hulumtimit në edukim**

Principet dhe metodatat e hulumtimit në edukim, përpilimi i një projekti hulumtues në edukim, (të paktën) disa hulumtime pilot.

#### **3. Teoria e edukimit, principet e të nxënit dhe mësimdhënies**

Menaxhimi i klasës, teoritë e të nxënit, baza kognitive e mësimdhënies, modelet dhe proceset e mësimt, zhvillimi i fëmijës, stili i mësimdhënies dhe të nxënit

#### **4. Metodatat dhe/ose praktikat e mësimdhënies**

Metodatat e përgjithshme të mësimdhënies dhe metodatat e veçanta lëndore ( gjuha dhe shkrim-leximi, shkenca, teknologjia, dhe edukimi matematikor), përvojat sistematike në teren ( observim dhe mësimdhënie)

#### **5. Studime të tjera (fakultative)**

Menaxhimi në edukim, shkollat efikase, vlerësimi, mentorimi, studimet gjinore/racore, arsimit të rriturve,...

Të gjithë këta komponentë i mundësojnë kandidatit të fitojë njohuri për shumicën e çështjeve të përgjithshme dhe të rëndësishme, që lidhen me punën e përditshme në klasë, dhe, nga ana tjetër, studimet në fushat e llojllojshme zgjedhore u mundësojnë atyre që t'i plotësojnë nevojat e veta dhe/apo aspiratat e ardhshme profesionale.

### **Metodatat**

Në përshkrimet e programeve mund të vërehen një sërë metodash: meqë disa programe janë dizajnuar posaçërisht për studentët me korrespondencë (Open University) ndërsa disa të tjera vetëm për studentë të rregullt (Maryland MCP). Metodatat ndryshojnë sipas këtij dimenzioni, të kontaktit më të madh apo më të vogël të drejtpërdrejtë me studime. Dimenzioni tjetër i dallimeve është natyrisht i natyrës regjionale, sipas vendit përkatës dhe pajisjeve teknologjike: La Trobe University (Australi) ka shumë metoda bashkëkohore për studime në distancë, si për shembull video-konferenca dhe diskutime elektronike.

Disa metoda të përgjithshme janë projektet e hulumtimit dhe tezat/ esejet e shkruara sipas numrit të caktuar të fjalëve.

### **Sistemi i kreditit.**

Të gjitha programet kanë strukturë krediti dhe sistem të saktë të transferimit të krediteve. Për sistemin evropian të krediteve, masa e rëndomtë për studimet e magjistraturës është 180 pika krediti. Në ShBA sistemi i krediteve është i ndryshëm, dhe në Maryland “Nevojiten përafërsisht 43 orë krediti” ( 1 orë krediti rëndom do të thotë një orë në javë gjatë një semestri). Magjistratura e mësimdhënies në Australi (La Trobe University) përmban “tetë njësi semestrare” ( një ligjeratë 2-3 orëshe apo një seminar në javë, për dhjetë javë rresht dhe një esej me 5000 fjalë), që gjithashtu përputhen me 180 pikë krediti. Studimet e mëparme kreditohen vetëm kur janë të nivelit të njëjtë ( niveli i shkallës së tretë). Poashtu caktohet sasia maksimale e krediteve të transferuara ( 90 pikë në Open University MA), dhe Jordanhill Scheme poashtu e lejon akreditimin e të nxëniet e mëparshem nga përvoja, në formën e një dosjeje. Në programin e Universitetit të Helsinkit ka mundësi të zavendësohen pjesë të disa modulave me një punim në konferencë akademike apo me një shkrim në revistë.

### **3.1 Çfarë njohurish specifike përfshihen në këto programe ( a është e mundshme të përfitohen njohuri plotësuese për përvojat e mësimdhënies në klasën multi-kulturore)?**

Njohuritë specifike përfshihen në lëndët fakultative. Të gjitha programet kanë mundësi t’u ofrojnë kandidatëve përzgjedhjen dhe krijimin e programit të vet. Duket se liria më e madhe në krijimin e programit individual ekziston tek **Open University**, ku studentët janë të lirë të zgjedhin nga një varg mundësish programin që më së miri përputhet me interesimin dhe me qëllimet e tyre profesionale; ata mund të studiojnë sipas hapit dhe ritmit të vet.

Në **La Trobe Magjistratura e Mësimdhënies** përmban një lëndë zgjedhore nga lista MED (1 njësi semestrare)

Opcioni i titullit **MMCP në Maryland** është zgjedhja e arsimit fillor apo të mesëm. Brenda arsimit të mesëm studentët mund të specializojnë në art, gjuhë angleze, gjuhë të huaja, matematikë, shkenca natyrore, apo shkenca shoqërore; një mundësi tjetër është lënda e kurikuleve të specializuara ( 3 semestra orë/kredite).

Më shumë mundësi mund te gjenden në programin **M.A. për Edukim në Maryland** për fushën e lidërshiptit dhe studimeve politike (EDPA), ku studentët mund të zgjedhin 3 deri 9 kredite nga kategoria e “Seminareve të fokusuara” dhe poashtu 0 deri në 6 kredite nga kategoria “Studime paralele”.

Në **Jordanhill Scheme** nxiten orientimet e dizajnuara personalisht me modulën Procesi dhe Planifikimi, që ofron 15 MS pika krediti brenda një programi individual të studimeve.

Në **programin finlandez**, studenti mund të përfitojë njohuri specifike me “Studime të avancuara “ (20 javë studimi) në një nga lëndët e M.Ed.

### **Mirënjohje**

Dëshirojmë t’i shprehim mirënjohje të veçantë Eva Burman-it nga La Trobe University (Australia) dhe Vivienne Collinson-it nga University of Maryland (USA).

Pa informatat e tyre nuk do të ishim në gjendje të bëjmë një krahasim të përmasave të këtylla në punimin tonë.

**Perkthyer nga: Lindita Tahiri**  
**Perkthimi u mundesua nga SEE ECN.**